Kronikë

Qëlloi në ajër dhe i drejtoi armën policisë, arrestohet 38-vjeçari në Kamës i dënuar më parë për drogë

Një i ri ne Kamëz i cili qëlloi në ajër e më pas i drejtoi armën policisë është vënë në pranga. Bëhet fjalë për 38-vjeçarin Fehtah Jata.

HOROSKOPI
RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
25 Shkurt, 18:17 | Përditesimi i fundit: 25 Shkurt, 18:35

TIRANË- Një i ri ne Kamëz i cili qëlloi në ajër e më pas i drejtoi armën policisë është vënë në pranga. Bëhet fjalë për 38-vjeçarin Fehtah Jata.

Ngjarja e cila tronditi banorët e zonës dhe i telefonuan policisë, ndodhi brenda një banese në rrugën "Moxart" në Kamëz.

LEXO EDHE:
Kanabis në xhep, dhunë në familje dhe të dehur në timon, 6 të arrestuar në Tiranë! Nën hetim 4 të tjerë, ja për çfarë akuzohen

Efektivët e policisë janë afruar në banesën në të cilën fshihej personi me armë dhe i kanë bërë thirrje që të hapte derën dhe t'i bindej kontrollit të Policisë.

38-vjeçari nuk i është bindur thirrjes së Policisë, por ka mbyllur derën dhe ka kërcënuar se do qëllonte në drejtim të punonjësve të Policisë.

Pas ndërhyrjes policia ka arrestuar 38-vjeçarin, banues në rrugën "Moxart", Kamzë, i cili edhe ka qenë i dënuar më parë për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". I riu u kap me armë në derë, me fishkë në fole gati për qitje.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan një armë zjarri kallashnikov, dy karikatorë me fishekë luftarak dhe 11 gëzhoja.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.

J.GJ./KT/Shqiptarja.com

TAG: kamez Tirane arme zjarri Fehtah Jata

Komento


© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A po reagon në mënyrën e duhur Perëndimi pas sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës?

Po Jo Nuk e di


Lajme të tjera

Kronikë



Vrau më thikë kunatin natën e Vitit të Ri pas debatit për mikpritjen e shqiptarëve, 20 vite burg Klajdi Shundit
25 Shkurt, 11:33

Kronikë



Fikën serverin sapo hyri policia, arrestohen tre të rinjtë që mashtronin të huajt përmes Call Center-it në Tiranë
25 Shkurt, 10:45

Kronikë




Qindra mijëra euro dhe lastra prodhimi parash false në Rinas, ndalohet kamerunasi i dytë, shpallet në kërkim një tjetër
24 Shkurt, 17:38

Kronikë



Përdorte lokalin për të vënë baste me telefon, arrestohet pronari në Tiranë
24 Shkurt, 15:41

Kronikë




Plagosën me thikë tre vajza pas një sherri, arrestohen dy të reja në Tiranë
24 Shkurt, 13:55

Kronikë




Dy kallashnikovë, një pistoletë dhe 4 kg kanabis në banesë, arrestohet 32-vjeçari në Vlorë
24 Shkurt, 13:21

Kronikë




Shiste heroinë me doza të vogla në Tiranë, arrestohet 37-vjeçari! Ja çfarë i gjeti policia në banesë
24 Shkurt, 10:46

Kronikë



Banorët e '5 majit' protestë para Drejtorisë së Policisë: Lironi shokët tanë nga qelia, po jetojnë dramë familjare! Na shembën ndërtesat, por jo jetën dhe të drejtat
23 Shkurt, 21:45

Kronikë



Report Tv në tunelin ku grabitësit gërmuan drejt bankës, hoqën tonelata gurë
Sokol Dema
23 Shkurt, 19:44

Sociale



"5 maji" kthehet në gërmadhë, banorët: Na vranë kujtimet
Enxhi Musaj
23 Shkurt, 18:15

Politikë



Veliaj pret kryebashkiakun e Selanikut Zervas: Bashkëpunim për Tiranën Kryeqytet Evropian të Rinisë! Mirënjohës për vëllazërinë që kemi mes qyteteve tona
23 Shkurt, 17:03

Kronikë



Përplasje dhe tensione mes banorëve të '5 majit' dhe policisë, në pranga 5, nis hetimi edhe për 2 të tjerë, njeri prej tyre i mitur
23 Shkurt, 16:15

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje